



# ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

UDHËZUES PRAKTIK  
PËR QYTETARËT

SI T'I DREJTOHEMI  
GJYKATËS KUSHTETUESE



[www.gjykatakushtetuese.gov.al](http://www.gjykatakushtetuese.gov.al)

Informacion, formularë dhe udhëzime  
praktike online

## ÇFARË ËSHTË ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL?

Mjeti për mbrojtjen  
e të drejtave themelore

## KUSH MUND TA PARAQESË ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL?

Ky publikim u mbështet nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit "Rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin më të mirë të standardeve të së drejtës për liri dhe siguri në Shqipëri", financuar nga Fondi i Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF), i cili bashkon tetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës: Finlandën, Gjermaninë, Irlandën, Luksemburgun, Holandën, Norvegjinë, Zvicrën dhe Mbretërinë e Bashkuar. Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorit/ve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës dhe Fondit të Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF)

Ankimi kushtetues individual përbën mjetin juridik në dispozicion të çdo individi, person fizik ose juridik, me të cilin ai vë në lëvizje gjykimin kushtetues për mbrojtjen përfundimtare të të drejtave dhe lirive të tij themelore, kur pretendon se i janë cenuar nga akte të pushtetit publik, përfshi vendimet gjyqësore.

**Vetë individi**, i cili përfshin çdo person, pavarësisht moshës, shtetësisë (shqiptar, i huaj, pa shtetësi ose me dy shtetësi, racës, etnisë, gjuhës, besimit ose ndonjë statusi tjetër).

**I mituri** - AKI përpilohet në emër dhe për llogari të tij, nga përfaqësuesi ligjor i të miturit. Ky i fundit nënshkruan kërkesën dhe aktet e tjera të nevojshme, si dhe ushtron të gjitha të drejtat dhe respekton detyrimet në gjykimin kushtetues.

**Individi madhor, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi** - AKI mund të përpilohet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej tij, me prokurë ose akt përfaqësimi dhe jo nga familjarët.

Kur ankimi kushtetues paraqitet nga përfaqësuesi i zgjedhur, ai përpilohet në emër të kërkuesit, por mund të nënshkruhet si vetëm nga kërkuesi apo vetëm nga përfaqësuesi i zgjedhur ashtu edhe nga të dy së bashku. Në këtë rast, akti i përfaqësimit është pjesë e dokumentacionit që paraqitet bashkëlidhur AKI. Në një rast të tillë, njoftimet e Gjykatës i drejtohen përfaqësuesit të kërkuesit.

**Personi juridik** - AKI nënshkruhet dhe paraqitet nga përfaqësuesi i tij. Ky i fundit mund ta ketë këtë cilësi për shkak të ligjit, statutit të personit juridik ose në bazë të një autorizimi/akti përfaqësimi. Sipas rastit, bashkëlidhur AKI paraqitet akti që dokumenton cilësinë e përfaqësuesit.



## KUR MUND TË BËHET ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL?

## KRITERET KRYESORE TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT KUSHTETUES INDIVIDUAL



Kur një: A) Ligj B) Akt i pushtetit publik C) Vendim gjyqësor



Ka cenuar drejtpërdrejt të drejtat dhe liritë themelore.



Në çdo rast ka rëndësi të veçantë përcaktimi i saktë i shkakut juridik të ankimit kushtetues, pra saktësimi i shkeljes konkrete të së drejtës ose lirisë themelore dhe i organit publik ose gjykatës që e ka shkaktuar këtë shkelje.



Gjykata Kushtetuese shqyrton jo vetëm shkeljet për të drejtat procedurale (të drejtën për proces të rregullt ligjor), por edhe shkeljet për të drejtat substanciale.

### Interesi vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real

Kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të drejtat e tij themelore.

### Shterimi i mjeteve juridike

Kërkuesi duhet të ketë shteruar më parë mjetet e zakonshme të ankimit në formë dhe substancë.



Kur objekt i AKI janë vendimet gjyqësore, kërkuesi mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm, ku ai të ketë ngritur, në thelb, përpara atyre gjykatave të gjitha pretendimet që paraqiten në ankimin kushtetues.



Kur objekt i AKI është një ligji ose një akt normativ, për sa kohë ai zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, kërkuesi duhet t'i kundërshtojë këto akte përpara gjykatave kompetente, duke ngritur pretendime edhe për kushtetutshmërinë e vetë aktit normativ.



Në raste përjashtimore përbushja e këtij kriteri është e pamundur, për shembull kur legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose kërkuesi provon se mjetet juridike në dispozicion janë joefektive.

### Afati 4-mujor

AKI paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit dhe në rastin e vendimeve gjyqësore brenda 4 muajve nga njohja efektivisht me vendimin gjyqësor të arsyetuar.

### Natyra kushtetuese e pretendimeve

Ankimi duhet të lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## ELEMENTËT FORMALË DETYRUES QË DUHET TË PËRMBAJË AKI



Emri dhe selia e Gjykatës Kushtetuese;



Emri, mbiemri ose emërtimi, dhe të dhënat bazë identifikuese përkatëse, përfshirë numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike e-mail, si dhe përcaktimi i adresës së vendbanimit, vendqëndrimit ose selisë së kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe/ose të përfaqësuesve të tyre;



Përcaktimi i objektit dhe bazës ligjore të kërkesës, parashtrimi dhe argumentimi i shkaqeve dhe shkeljeve të natyrës kushtetuese të pretenduara;



Paraqitja e dokumenteve, provave apo materialeve të tjera që shoqërojnë ankimin kushtetues, të cilat listohen dhe paraqiten në kopje të mjaftueshme për t'ua vënë në dispozicion secilit pjesëmarrës në gjykimin kushtetues;

**Aktet e organeve publike ose vendimet e gjykatave duhet të jenë pjesë e akteve shoqëruese të AKI. Ato paraqiten në kopje origjinale ose të noterizuara të të gjitha akteve ose vendimeve gjyqësore që kundërshtohen në objektin e tij.**



Nënshkrimi i kërkuesit dhe/ose i përfaqësuesit të tij, si dhe paraqitja e aktit të përfaqësimit të këtij të fundit.

## NË CILAT FAZA KALON SHQYRTIMI I ANKIMIT KUSHTETUES INDIVIDUAL?

**Shqyrtimi paraprak nga Kolegji** i përbërë nga tre anëtarë ose Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila përbëhet nga të gjithë anëtarët e Gjykatës dhe mbledhet me praninë e jo më pak se gjashtë prej tyre.

**Shqyrtimi në seancë plenare**, e cila zhvillohet mbi bazë dokumentesh ose në prani të palëve, vetëm për ato kërkesa ankimore që kanë kaluar filtrin paraprak të vlerësimit në Kolegji ose Mbledhjen e Gjyqtarëve.



**Vendimarrja:** Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të dhëna nga Kolegjet, Mbledhja e Gjyqtarëve ose në seancë plenare janë të detyrueshme për zbatim.

# SI T'I DREJTOHEMI GJYKATËS KUSHTETUESE

Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese [www.gjykatakushtetuese.gov.al](http://www.gjykatakushtetuese.gov.al) përmban informacion të detajuar mbi aksesin në Gjykatën Kushtetuese

Në ballinë, klikoni ikonën “Mbi Gjykatën Kushtetuese” (në këndin e sipërm djathtas), dhe hapni rubrikën “Si t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese” ku do të gjeni informacion mbi:



**Formularin tip** për hartimin e kërkesës për ankimin kushtetues individual drejtuar Gjykatës Kushtetuese




**Këshilla praktike** për plotësimin dhe paraqitjen e kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.



**Informacioni i zgjeruar** për çdo pyetje që mund të keni përsa i përket aksesit në Gjykatën Kushtetuese.

Për më shumë informacion hapni rubrikën “Si t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese”.



## Formulari Tip

Ndihmon për hartimin e ankimit kushtetues individual. Formulari përmban seksione të strukturuar për të dhënë informacionin e nevojshëm dhe shërben si udhëzues për të plotësuar një kërkesë në përputhje me standardet ligjore.

### KËRKESË<sup>1</sup>

#### DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE

##### KËRKUES:\*

1. Emri, atëzia, mbiemri; 2) Datëlindja; 3) Adresa e plotë (në të cilën preferoni të kontaktoheni nga Gjykata Kushtetuese), përfaqësuar nga av. \_\_\_\_\_, me prokurë nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.  
(Nr. telefoni, adresa email-it të kërkuarit dhe/ose të avokatit)
2. (Nëse ka më shumë se një kërkuar, të dhënat duhet të jepen si më lart për secilin nga kërkuarit).

##### SUBJEKT I INTERESUAR (ose SUBJEKTE TË INTERESUARA, sipas rastit):\*

1. (1. Emri, mbiemri; 2) Adresa e plotë e subjektit/ëve të interesuar/ia)
2. (Nëse ka më shumë se një subjekt të interesuar, të dhënat duhet të jepen si më lart për secilin nga subjektet).

##### OBJEKTI I KËRKESËS:\*

- 1) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. \_\_\_\_, datë \_\_ të Gjykatës \_\_\_\_; nr. \_\_\_\_, datë \_\_ të Gjykatës \_\_\_\_\_. (Objekti i kërkesës duhet të përmblajë qartësisht vendimin ose vendimet gjyqësore që kundërshtohen para Gjykatës Kushtetuese. Sipas rastit, mund të kundërshtoni një vendim ose disa vendime të gjykatave).

Ose:

- 2) Shfuqizimi si antikushtetues i aktit të pushtetit publik nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_.<sup>2</sup>

##### BAZA LIGJORE:\*

Neni/Nenet \_\_\_\_ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni/nenet \_\_\_\_ të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. (Luatemi përcaftoni qartësisht parashikimet kushtetuese dhe ligjore, që garantojnë të drejtat që pretendoni se ju janë shkelur! Në këtë pjesë mund të referoni dhe nene të ligjeve ose akteve të tjera që garantojnë të drejtat tuaja).



Kërkuar mund të paraqitet edhe pranë Gjykatës Kushtetuese për të tërhequr një model të formularit të AKI.



Në këtë rast administrata e Gjykatës Kushtetuese NUK mund të ndihmojë në plotësimin e këtij formulari ose të japë këshilla apo udhëzime për këtë qëllim.

## Këshillat praktike

Japin udhëzime të hollësishme për plotësimin dhe dorëzimin e ankimeve drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe synojnë të ndihmojnë individët të përgatisin kërkesa në mënyrë të rregullt dhe ligjore, duke shmangur problemet teknike apo procedurale.

Për të pasur një qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në formularin e aplikimit, këshillat praktike dhe aksesin në Gjykatën Kushtetuese, thjesht skanoni kodin QR :



### Dorëzimi fizik në protokoll ose me postë

**Dorëzimi dorazi:** Individu mund të dorëzojë AKI në zyrën e protokollit pranë Gjykatës Kushtetuese, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

**Dërgimi me postë:** Adresa e selisë së Gjykatës Kushtetuese është "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 26, Tiranë". Data e dorëzimit të AKI për qëllime të llogaritjes së afatit ligjor konsiderohet data e pranimit të tij nga zyra postare.

**Dërgimi me postë elektronike:** Në rast se AKI paraqitet me postë elektronike e-mail në adresën zyrtare elektronike të Gjykatës, ai duhet të përmbajë nënshkrimin me elementet e sigurisë sipas legjislacionin për regjistrimin elektronik dhe brenda 10 ditësh duhet të paraqitet kopje e tij në Gjykatë. Nëse kjo procedurë nuk respektohet, AKI arkivohet.

### Mbrojtja e të dhënave personale

Kërkuesi, kur paraqet kërkesën në Gjykatën Kushtetuese ka të drejtën të kërkojë që të dhënat personale të mbahen anonime. Në këtë rast, ai duhet të paraqesë një kërkesë të posaçme, të nënshkruar prej tij, ku arsyetohen qartë pasojat që mund të sjellë publikimi i të dhënave personale për jetën e tij private dhe familjare, etj., si dhe përcaktohen konkretisht të dhënat që nuk duhet të bëhen publike dhe mënyrën e anonimizimit të tyre. Ky përbën përjashtim nga rregulli i zakonshëm që zbatohet në shpalljen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

## ORIENTIM NË FAQEN ZYRTARE

### Kërkim për vendimet

- ➔ Përdor opsionet e kërkimit:
- 📁 Sipas kategorisë
- 👤 Sipas kërkuetit
- 📅 Sipas vitit
- 🔍 Sipas fjalëve kyçe/të dhënave të tjera

Për të pasur një qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese thjesht skanoni kodin QR :





## Kalendari i seancave

- ➔ Faqja kryesore (Kalendari i seancave)
- 📅 Kliko mbi datën
- 👤 Shfaqen:
  - Seancat e planifikuara
  - Kërkuesi dhe objekti i çështjes



## Njoftime për vendimmarrjen

- ➔ Kliko në rubrikën “Njoftime për vendimmarrjen” në faqen kryesore.
- ☑️ Çdo qytetar mund të informohet mbi veprimtarinë vendimmarrëse të Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE

Kalendari i Seancave

TRANSMETIM I DREJTPËRDREJTË / LIVE STREAM

PRILL 2026


HEN	MAR	MER	ENJ	PRE	SHT	DIE
30	31	1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	1	2	3

SEANÇË PLENARE MBI BAZË TË DOKUMENTEVE

SEANÇË PLENARE MBI BAZË TË DOKUMENTEVE

NJOFTIME MBI VENDIMARRJEN

Për të pasur një qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në njoftimet mbi vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese thjesht skanoni kodin QR




## LIVE STREAM

- ➔ Faqja kryesore
- ➔ Kliko “Transmetim i drejtpërdrejtë”
- ☑️ Ndiq seancën plenare publike në kohë reale

TRANSMETIM I DREJTPËRDREJTË / LIVE STREAM

Për të pasur një qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në kalendarin e seancave të Gjykatës Kushtetuese thjesht skanoni kodin QR :



Për të pasur një qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në Kanalin Youtube të Gjykatës Kushtetuese thjesht skanoni kodin QR





## KONTAKTET ZYRTARE

---

 Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 26, Tiranë, Shqipëri

 Telefoni: **+355 4 22 31 603**

 E-mail: **info@gjykatatushtetuese.gov.al**

 Web: **www.gjykatatushtetuese.gov.al**

